

BANKA E SHQIPËRISË



TË NJOHIM BONOT E THESARIT

Për informacione të mëtejshme, ju lutem kontaktoni Sektorin e Bonove të Thesarit, pranë Bankës së Shqipërisë.

+ 355 4 241 93 01/02/03
+ 355 4 241 94 09/10/11

1. BONOJA E THESARIT

Bonoja e Thesarit e qeverisë shqiptare është një instrument i tregtueshëm borxhi me maturim deri në një vit, që emetohet dhe garantohet nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Bonot e Thesarit emetohen në monedhë kombëtare (Lek) dhe në valutë dhe kanë afate maturimi fillestare 3, 6 dhe 12-mujore¹.

Bonot e thesarit emetohen (nxirren për shitje) nga qeveria nëpërmjet ankandit. **Kjo formë nënkupton që investitorët duhet të konkurrojnë për blerjen e këtij instrumenti.** Konkurrimi bëhet nëpërmjet vendosjes së normës së interesit, që quhet *yield* i bonove të thesarit. *Yield*-i i bonove të thesarit është bazë për llogaritjen e çmimit të blerjes së bonos së thesarit, sipas formulës së mëposhtme:

$$C_b = \frac{V_n}{1 + \frac{y}{365} \times D}$$

ku,

C_b - çmimi i blerjes

V_n - vlera nominale

y - *yield* (norma e interesit) i shprehur në bazë vjetore

D - ditët deri në maturim

¹ Afati i investimit është diferenca në kohë midis datës së investimit dhe datës së kthimit të investimit. Data e investimit është data kur është blerë bonoja e thesarit në tregun primar (data e emetimit) ose në tregun sekondar. Data e kthimit të investimit është data kur bonoja e thesarit maturohet ose kur ajo shitet në tregun sekondar.

Interesi (kthimi) i përfituar nga investimi në bono thesari llogaritet si diferencë e çmimit të blerjes së bonos me vlerën nominale të saj. Raporti i kësaj difference me çmimin e blerjes të llogaritur në bazë vjetore, shpreh normën e kthimit të përfituar nga investimi.

Bonot e Thesarit janë të tregtueshme dhe mund të shiten/blihen para afatit të maturimit. Tregtimi i një bonoje thesari mund të bëhet deri në 1 (një) ditë para maturimit. Tregtimi mund të bëhet me subjektet e licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), ku bëjnë pjesë edhe bankat tregtare.

Në datën e maturimit të bonos së thesarit, aplikohet tatimi mbi të ardhurat (kthimi nga investimi) e përfituara nga investimi. Aktualisht, tatimi është 15%.

2. ANKANDET E BONOVE TË THESARIT DHE PJSËMARRJA E INDIVIDËVE

Kalendari i ankandeve të emetimit të bonove të thesarit përcaktohet nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Normalisht, ankandet për emetimin e bonove të thesarit me afat maturimi 3 dhe 6-mujor, organizohen një herë në muaj, ndërsa ankandet për emetimin e bonove me afat maturimi 12-mujor organizohen çdo dy javë. Si rregull, ankandet zhvillohen ditën e martë, ndërsa emetimi i letrës bëhet dy ditë më vonë, ditën e enjte. Zhvillimi i ankandit njoftohet paraprakisht nga Ministria e

Financave² dhe Banka e Shqipërisë³ nëpërmjet publikimit të informacionit në faqet respektive të internetit.

Individët mund të marrin pjesë në ankandet e emetimit të bonove të thesarit me kërkesa konkurruese ose jokonkurruese. Pjesëmarrja **me kërkesë konkurruese** nënkupton vendosjen e një interesi (*yield-i*), mbi bazën e të cilit do të llogaritet çmimi që investitori preferon të paguajë për blerjen e bonos së thesarit. Pjesëmarrja **me kërkesë jokonkurruese** nënkupton pranimin e *yield-it* mesatar të ponderuar, i cili do të llogaritet si mesatare e ponderuar e *yield-eve* të kërkesave konkurruese të shpallura fituese.

Në ankand, kërkesat konkurruese renditen nga *yield-i* më i ulët i kërkuar deri tek *yield-i* më i lartë, deri sa të plotësohet shuma e shpallur nga qeveria për emetimin e bonove. Pra, në rast se kërkesa e pjesëmarrësve për blerjen e bonove është më e lartë se shuma e emetuar nga qeveria, kërkesat konkurruese me *yield-in* më të lartë, nuk do të pranohen nga qeveria dhe për rrjedhojë investorët nuk do të mund të blejnë bono thesari në atë ankand.

Shuma e shpallur për emetimin e bonove të thesarit nga qeveria, pas plotësimit të pjesëmarrjes së Bankës së Shqipërisë, ndahet në mënyrë të barabartë **ku jo më shumë se 50% emetohet për kërkesat jokonkurruese dhe pjesa e mbetur për kërkesat konkurruese**. Kjo nënkupton që në

² <http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/buxheti-thesari-borxhi/borxhi/ankandet-e-emetimit-te-letrave-me-vlere-te-qeverise>

³ http://www.bankofalbania.org/web/Kalendari_i_Ankandeve_2016_1.php

rast se shuma totale e kërkesave jokonkurruese është më e lartë se hapësira në dispozicion e shpjeguar më sipër, atëherë aplikohet prorata, për të llogaritur pjesën e fondeve që do të pranohen për investim në bono thesari. **Prorata është raporti i hapësirës në dispozicion për kërkesat jokonkurruese kundrejt shumës totale të kërkesave jokonkurruese, e shprehur në përqindje.**

Shembull 1:

Shuma në dispozicion për kërkesat jokonkurruese është 3 miliardë lekë. Shuma e kërkuar nga individët me kërkesa jokonkurruese është 4.5 miliardë lekë. Në këtë rast, prorata është 66%. Pra, individë do të investojë 66% të shumës së kërkuar, ndërsa pjesa tjetër do t'i rikthehet.

Shuma minimale për të marrë pjesë në ankandet për blerjen e bonove të thesarit është 300.000 lekë. Kjo shumë mund të rritet me shumëfisha të 10.000 lekëve. Shuma maksimale e lejuar për të marrë pjesë në ankand me kërkesë jokonkurruese është 30 milionë lekë. Kërkesa me një shumë më të madhe se 30 milionë lekë konsiderohet automatikisht si kërkesë konkurruese.

Rezultatet për ankandin e bonove të thesarit shpallen në të njëjtën ditë të organizimit të tij dhe publikohen në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë⁴.

Për fituesit në ankand jepet dokumenti **“Vërtetim për shpalljen fitues”**, i cili përmban informacion për rezultatin e investimit në bonon e thesarit.

⁴http://www.bankofalbania.org/web/Rezultatet_e_Ankandeve_2015_1.php

3. PJESËMARRJA E INDIVIDËVE NË ANKANDET E BONOVE TË THESARIT NËPËRMJET BANKËS SË SHQIPËRISË

Individët mund të marrin pjesë në ankandet për blerjen e bonove të thesarit nëpërmjet bankave tregtare të licencuara nga AMF për tregtimin e letrave e vlerë, si dhe nëpërmjet sporteleve të Bankës së Shqipërisë në Tiranë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Lushnjë dhe Gjirokastrë. **Nëpërmjet sporteleve të Bankës së Shqipërisë, individët mund të marrin pjesë vetëm në ankandet për bonot e thesarit të emetuara në monedhën vendase – Lek.**

Për të marrë pjesë në ankandin e bonove të thesarit nëpërmjet sporteleve të Bankës së Shqipërisë, individit duhet që, përpara organizimit të ankandit, të ketë përfunduar procedurën e mëposhtme:

- i. Të urdhërojë bllokimin e fondeve në emër të tij për pjesëmarrje në ankand pranë një banke tregtare. Individit mund të informohet në sportelet e Bankës së Shqipërisë mbi bankat që kanë marrëveshje me Bankën e Shqipërisë për këtë qëllim.
- ii. Të paraqitet pranë sporteleve të Bankës së Shqipërisë për të hapur llogarinë e titullit duke vënë në dispozicion numrin e llogarisë në formatin IBAN që i kanë dhënë bankat. Për hapjen e llogarisë së titullit, individit nënshkruan kontratën përkatëse me Bankën e Shqipërisë.
- iii. Në rast se individit ka llogari titulli të hapur në Bankën e Shqipërisë nga veprimet e tij të mëparshme (sipas

pikës ii), ai konfirmon ose risjell numrin e llogarisë së *cash*-it në bankën tregtare në formatin IBAN dhe më pas plotëson kërkesën për pjesëmarrje në ankand.

Në ditën e emetimit të bonos së thesarit ose në çdo kohë pas saj, individi ka të drejtë të tërheqë pranë sporteleve të Bankës së Shqipërisë “Vërtetimin mbi shpalljen fitues”. Ndërsa, transaksionet në *cash* (si më poshtë) do të shlyhen automatikisht në ditën e emetimit të bonos së thesarit, në numrin e llogarisë së *cash*-it në formatin IBAN që ka paraqitur individi nga banka tregtare:

- diferenca midis çmimit të blerjes dhe vlerës nominale (të llogaritur sipas përshkrimit në pikën 1);
- kur shuma e kërkuar për investim nuk është pranuar e plotë (rastet kur aplikohet prorata), mbetja do të kalojë automatikisht në llogarinë e *cash*-it të individit.

Në ditën e maturimit të bonos së thesarit, vlera nominale e bonos së thesarit pas mbajtjes së tatimit kalon në llogarinë e *cash*-it të dhënë nga individi. Ky veprim nuk ndodh në rastet kur individi përputh në të njëjtën ditë, pjesëmarrjen në një ankand për emetimin e bonove të thesarit me maturimin e bonos së thesarit që zotëron.

Kërkesat për pjesëmarrje në ankandet e bonove të thesarit nëpërmjet Bankës së Shqipërisë bëhen deri në dy ditë para datës së organizimit të ankandit.

Shembull 2:

Një individ plotëson kërkesën jokonkurruese për të blerë bono thesari me afat fillestar 12-mujor në vlerën nominale 10,000,000 lekë (dhjetë milionë lekë). Yield-i mesatar i ponderuar përcaktohet nga ankandi dhe del për shembull 5.00%. Me anë të formulës llogaritet çmimi i blerjes së bonove, 9,525,052.19 lekë. Diferenca e çmimit të blerjes me vlerën nominale që në këtë rast është 474,947.81 lekë kalon në llogarinë cash të individit në bankën tregtare në ditën e emetimit. Në rast se individ i nuk ka paraqitur kërkesë për pjesëmarrje në ankandin e radhës, dita e emetimit të të cilit përkon me ditën e maturimit të bonos së thesarit që zotëron, në ditën e maturimit individit i kalon në llogarinë e cash-it në bankën tregtare vlera nominale e bonos së thesarit e reduktuar me tatimin e mbajtur mbi kthimin nga investimi. Kthimi nga investimi është 474,947.81 lekë, në kushtet kur individ i ka investuar 9,525,052.19 lekë në ditën e emetimit të bonos dhe në ditën e maturimit po merr 10,000,000 lekë që është vlera nominale e bonos së thesarit që zotëron. Tatimi mbi këtë kthim është 15% e vlerës ose 71,242.17 lekë. Pra, vlera që kalon në llogarinë e cash-it të individit pranë bankës tregtare në ditën e maturimit është 9,928,757.83 lekë (vlera nominale prej 10,000,000 lekësh e reduktuar me tatimin prej 71,242.17 lekësh).

Në rast se individ i ka marrë pjesë dhe ka fituar në një ankand për të blerë bono thesari në të njëjtën vlerë nominale (10,000,000 lekë) dhe data e emetimit të bonos së re përputhet me datën e maturimit të bonos që zotëronte, në llogarinë e individit kalon diferenca e vlerës së maturuar prej 9,928,757.83 lekësh (e llogaritur si më sipër) me çmimin e blerjes së bonos së re të thesarit (e llogaritur në bazë të yield-it mesatar të përcaktuar në ankandin e ri).